



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë praktike e Gjuhës B (2)

Ngarkesa: 6 kredite; 84 orë mësimore; 84 Ushtrime/laborator
Viti / Semestri : Viti I , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda gjuhë praktike është një lëndë e detyrueshme e cila synon formimin gjuhësor –kulturor të studentit në bazë të Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët duke i vënë theksin zhvillimit të katër aftësive parësore: lexim, shkrim, komunikim e dëgjim dhe atyre të integruara: përmbledhja, përkthimi, parafrazimi, marrja e shënimeve, dialogu, monologu, diktimi, të lidhura ngushtë me formimin e thelluar gjuhësor të studentit

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Zhvillimi i aftësive gjuhësore për të përftuar një bagazh gjuhësor të domosdoshëm për formimin e studentit në studimet e tij vijuese në fushën përkatëse për nivelin përkatës: aftësia për të kuptuar dhe ndërvepruar si me tekstin e shkruar dhe atë të folur italian të sferës së përditshme apo në punë, të ndjenjave dhe dëshirave që mund të paraqiten në mesazhe emaile etj. në çfarëdolloj konteskti në të cilin ai paraqitet,përshkrimin e ngjarjeve përfshi elementet specifike të këtij kontekstualiteti.
- 2.Zhvillimi i leksikut për formimin e një bagazhi leksikor të nevojshëm për të rritur jo vetëm kuptueshmërinë e materialeve gjuhësore të paraqitura në kontekste të ndryshme por edhe zhvillimin e aftësive komunikuese në një nivel gjuhësor më të përparuar se ai paraprak.
- 3.Zhvillimin e aftësive kuptimore të tilla që i mundësojnë atij të kuptojë thelbin e mesazheve që përcillen të qarta në gjuhën standarte mbi argumente të ndryshme në kontekste të ndryshme me të cilat mund të përballet në shkollë, punë, kohën e lirë, në situata që mund të paraqiten nëse udhëtohet apo jetohet në vendin ku flitet gjuha. Të zhvillojë aftësitë që të kuptojë pa qenë e nevojshme për një përgatitje paraprake mbi argumente personale familjare apo të tjera që kanë lidhje me jetën e përditshme, diskutime mbi çështje aktuale dhe shprehjen e opinion.
- 4.Zhvillimin e aftësive prodhuese si me gojë ashtu edhe me shkrim me qëllim që të jetë i aftë të përshkruajë përvoja, ngjarje, shpresa, projekte, dëshira, opinione, etj. Të jetë i aftë gjithashtu të ndërveprojë natyrshëm mbi argumente të njohura për të dhe në cilat përdoret gjuha standarte dhe kur përdoret një komunikim llogjik, i qartë.
- 5.Zhvillimi në një nivel me të përparuar, drejt B2, i aftësive për të kuptuar tekstetë komunikuar me gojë apo me shkrim si ato të llojit të konferencave apo të ndjekë argumentime më komplekse por që gjithsesi janë me tematikë të njohur për studentin. Të kësaj natyre janë psh: lajmet gazetave, televizive apo radio, rrjeteve sociale, emisione të ndryshme dhe filma ku gjuha është standarte